



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Kastrati” shpk.

Adresa: Durres Lagja 14, Rruga Tirana, Prane Gjykates se Apelit, Shkozet

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

Procedura e prokurimit e zgjedhur në mbështetje të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 30 si dhe Neni 35/1, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu IV, Neni 33; si dhe Kreut V, Neni 45, pika 1, rekomandimit Nr. 13566 Prot dt 06.11.2017 nga Agjensia e Prokurimit Publik dhe udhëzimit Nr. 6 dt 16.01.2018 për ”Përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, rekomandimit Nr.9941 prot dt 08.11.2018 nga APP ”Mbi shpalljen e procedurave të prokurimit për vitin 2019” është **“Procedurë e hapur”, “Marrëveshje kuadër”**.

Loti I: Blerje naftë (Bludiesel)”

Referenca e procedures: REF-46972-12-30-2019

Loti i parë: REF-46974-12-30-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Loti I: Blerje naftë (Bludiesel)” dhe finalizimi i saj me lidhjen e kontratës.

Fondi limit per lotin e pare: 188.068.020 (njëqind e tetëdhjetë e tetë milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëzet) lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të VKB-së Nr. 159, datë 21.12.2018, për “Miratimin e Programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019”.

Kohëzgjatja e kontratës: Kontratat do të jepen brenda periudhës: Nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuader me Operatorët ekonomikë të sukseshëm për secilin lot, me afat 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër për secilin lot. Dorëzimi i karburantit do të kryhet sipas percaktimit të bere ne shtojcen 12 “Sasia dhe grafiku i levrimit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 29.01.2020, Ora: 11:00.

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini Nr. 53 datë 31 Dhjetor 2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: d oferta ekonomikisht më e favorshme **X** çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Kastrati” shpk me NUIS- J61813529P

Çmimi total i ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **15.4%**. Kontratat do të jepen brenda periudhës: Nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuader me Operatorët ekonomikë të sukseshëm për secilin lot, me afat 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër për secilin lot. Dorëzimi i karburantit do të kryhet sipas percaktimit të bere ne shtojcen 12 “Sasia dhe grafiku i levrimit.

2. Bashkimi i Operatoreve ekonomikë ”Olsi” shpk & ”2A2F-L OIL” shpk me NUIS J63423463I & NUIS L41915013M

Çmimi total i ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **9.2%**. Kontratat do të jepen brenda periudhës: Nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuader me Operatorët ekonomikë të sukseshëm për secilin lot, me afat 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër për secilin lot. Dorëzimi i karburantit do të kryhet sipas percaktimit të bere ne shtojcen 12 “Sasia dhe grafiku i levrimit.

3. Operatori ekonomik ”Flady Petroleum”

Çmimi total i ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **13 %**. Kontratat do të jepen brenda periudhës: Nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuader me Operatorët ekonomikë të sukseshëm për secilin lot, me afat 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër për secilin lot. Dorëzimi i karburantit do të kryhet sipas percaktimit të bere ne shtojcen 12 “Sasia dhe grafiku i levrimit.

• Operatori ekonomik ”Resuli ER”

Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

Janë s’kualifikuar Operatorët Ekonomikë si më poshtë vijon:

- BOE "Olsi" shpk & "2A2F-L OIL" shpk
- Operatori ekonomik "Flady Petroleum"
- Operatori ekonomik "Resuli ER"

1. BOE "Olsi" shpk & "2A2F-L OIL" shpk është s'kualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

Në kriteret e e vecanta për kualifikim konkretisht në rubrikën "Kapacitetit teknik dhe profesional" pika 2.3/5 e ndryshuar me shtojcën dt.20.01.2020 për ndryshim dhe modifikim të dokumentave standarte të tenderit është përcaktuar se:

*"Subjekti ofertues duhet të paraqese listen e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice në qytetin e Tiranës (minimumi 7) brenda dhe jashtë unazës, vertetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj) për këto stacione, detyrimisht që nga 01 janari 2019 e në vazhdim. **Këto stacione duhet të jenë të pajisura me Licensë /Autorizim lëshuar nga pushteti vendor për tregëtim karburanti me pakicë**, Leje mjedisore të tipit C të lëshuar nga QKL, vertetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), certifikatë e mbrojtjes nga zjarri nga MZSH dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë datën e hapjes së ofertave".*

- *Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga BOE sa më sipër cituar për përmbushjen e këtij kriteri konstaton se të dy operatorët ekonomikë nuk kanë paraqitur **Licensë /Autorizim lëshuar nga pushteti vendor për tregëtim karburanti me pakicë**, për stacionet që disponojnë. Lidhur me përmbushjen e këtij kriteri, OE disponojnë dokumentacion që vërteton kryerjen e pagesave vendore për pajisjen me këtë licensë/autorizim por jo në vetvete Autorizimin. Operatori ekonomik "Olsi" shpk disponon licensë/autorizim vetëm për pikën e ndodhur në adresën "Autostrada Tiranë Durrës 20 m në të djathtë të mbikalimit të kamzës e cila është e vlefshme deri në dt 18.06.2020. Pra për të gjitha pikat e tjera nuk ekziston një dokument i tillë Autorizim/licensë i lëshuar nga pushteti vendor në emër të OE palë të këtij bashkimi ekonomik. Në këtë mënyrë bashkimi i shoqërive bie në kundërshtim me Kreun VIII, neni 74, ku citohet se: "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pika 3, të VKM nr:914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku parashikohet se: "Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje**". Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr:9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se:*

*“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur **të gjitha kriteret** që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

1. *Nuk ka paraqitur flete analizat të lëshuar nga ISHTI per lotin qe konkuron në bazë të përqindjes së partneritetit operatori ekonomik **”2A2F-L OIL” shpk.***

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

2. Operatori ekonomik ”Flady Petroleum” shpk është s’kualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se **Operatori ekonomik “Flady Petroleum”** nuk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik **“Flady Petroleum” s’kualifikohet** pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik ”Resuli ER” shpk është s’kualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria **“Operatori ekonomik “Resuli ER”** nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik **“Resuli ER” s’kualifikohet** pasi nuk ka paraqitur

dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5 të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar **si operator ekonomik i suksesshëm per lotin e pare :**

1. **Operatori Ekonomik “Kastrati” shpk me NUIS-J61813529P**

Çmimi total i ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **15.4%**. Kontratat do te jepen brenda periudhës: Nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuader me Operatorët ekonomikë të suksesshëm për secilin lot, me afat 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër për secilin lot. Dorëzimi i karburantit do te kryhet sipas percaktimit te bere ne shtojcen 12 “Sasia dhe grafiku i levrimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19.02.2020.

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim.